



Foundation for Internet and Society Фондација Метаморфозис - Скопје
Foundation for Metamorphosis - Skopje

Политика за корекции и појаснувања

Бр. 01-2711
21.01.2019
СКОПЈЕ

Politika për korrigjime dhe sqarime

HYRJE

Ky dokument e sqaron menyrën se si opinioni mund të reagojë për materialet e publikuara në kuadër të Fondacionit Metamorfozis për precizim, plotësim ose sqarim të materialeve të publikuara. Ky dokument, gjithashtu e definon dhe rregullon procesin e brendshëm në Fondacionit Metamorfozis për menyrën se si do të veprohet dhe kush do të veprojë në situata kur do të ketë reagim nga përfaqësues të opinionit publik për ndonjë material të publikuar.

Politika për korigjime dhe sqarime vlen për të gjithë materialet e publikuara në Fondacionin Metamorfozis dhe është e vetmja në nivel të të gjithë organizatës. Redaktorët dhe redaksitë e publikime kanë për obligim ta realizojnë këtë politik plotësisht në kuadër të publikimeve të tyre.

MËNYRA E IMPLEMENTIMIT

Fondacioni Metamorfozis dhe të gjithë publikimet e tij, kanë politik për korigjime e cila bazohet sipas;

- Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Neni 16, pika 4),
- Ligjit për medime (Neni 17-25).
- Ligjit për përgjegjësi qytetare nga shpifjet dhe ofendimet (Neni 14) dhe
- Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë (paragrafi 3-5 nga parimet e sjelljes dhe Nenit 3).

Citimet e nevojshme nga këto dokumente janë përfshirë në Aneksin 1 të këtij dokumenti. Të gjithë kërkesat për korigjime dhe sqarime, të cilat kanë të bëjnë me publikimet e Fondacionit Metamorfozis, mund të dërgohen në afat prej 30 ditësh (Neni 2 nga Ligji i medimeve) nga dita e publikimit të materialit për të cilin kërkohet korigjim, nëpërmjet një formulari përkatës të publikuar në të gjithë publikimet. Atje mund të dërgohen vërejtje për përmirësime të të pavërtetave eventuale, gabimeve, paqartësive, për të cilat vlerësohet se duhet të korigjohen.

Personat përgjegjës nga secili publikim do t`i kontrollojnë vërjetjet dhe në afatin e caktuar me ligj prej dy ditësh (Neni 19 nga Ligji për medime) do të dërgojnë përgjigje adekuate.

Informacioni për çdo korigjim ose plotësim të bërë, të krijuar në bazë të kërkesës nga anëtar i publikut, do të vendoset qartë në fillim të shkrimit për të cilin është kërkuar.

Personat të cilët janë të prekur personalisht dhe duan të marrin përgjigje të drejtpërdrejtë në adresën e tyre elektronike, lutem që ta theksojnë këtë në mesazhin me të cilin kërkojnë korigjim ose sqarim.

Në Shkup,

metamoprhosis.mk +389 2 3109 325

22.01.2019

Bardhyl Jashari, drejtor

Apostol Guslarot Str. 40,1000 Skopje, Rep. of Macedonia